

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqipëria mund 2-0 Bjellorusinë në UEFA Nations League
ADRESA	https://lajmifundit.al/shqiperia-mund-2-0-bjellorusine-ne-uefa-nations-league-i1338863
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 21:03:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 22:52:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1209f443dfc9b8bd5388530a479604895f1f711dc85f126a31ceb83882ff19ad
TEKSTI	887e1466efd79b0d3d26ffb648116f6c4a73d9f61f3075b8c4c03bf6bfdbfa53
PAMJA	2966d1ba0ce3ba7d31c1764a1c8cbcca97c510f80bdcf8a74d697376df5663a0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2f73550a4d4e425ee584b1983b98dac1ff71798312809bfdd63c697ff54f776f
E MËPARSHMJA	1ec97f87a610614ecb1ecba3c0e0acb3720d9708eb67575ce954c7d100d949c3
RRËNJJA MERKLE	6a69f75a9f7cafbdfdd1c20b19877b2e8e1ea7566c7617baea4d7a10149f8f21
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2f73550a4d4e425ee584b1983b98dac1ff71798312809bfdd63c697ff54f776f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Shqipëria mund 2-0 Bjellorusinë në UEFA Nations League

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Të flesh vonë mund të mos jetë zgjedhja më e mirë për zemrën

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Tension në stadium, tifozët kuqezi me thirrje kundër qeverisë: Rama jepe dorëheqjen!

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Dy yje, një histori e errët! Sydney Sweeney dhe Belmont Cameli bëhen bashkë për filmi e ri...

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Marshimi i protestës/ Policia i bllokoi rrugën qytetarëve pranë Liqenit Artificial, shkak ndeshja në Air Albania

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Shqipëria mund 2-0 Bjellorusinë në UEFA Nations League



LAJMI FUNDIT / 26 SEPTEMBER 2026, 22:52

Shpërndaje

SPORT



Shqipëria ka mposhtur 2-0 Bjellorusinë në "Air Albania" në ndeshjen e parë të Ligës së Kombeve. Që në startin e ndeshjes qasja ishte ndryshe nga sa ishim mësuar të shihnim, e një skuadre që kërkon të guxojë dhe të dominojë rivalin. Skuadra e Maranit luan shpejt, me tek prekje dhe pa frikë.

Kristjan Asllani dhe Ernest Muçi ishin autorët e golave, ndërsa skuadra kuqezi pati edhe disa raste të tjera për të thelluar avantazhin.

Ndeshja nisi me ritëm. Shqipëria provoi që në minutat e para, me Arbër Hoxhën dhe më pas Rey Manajn, ndërsa Bjellorusia iu afrua portës së Etrit Berishës në minutën e 8-të. Portieri kuqezi reagoi mirë dhe ndali tentativën e miqve.

Pas një faze ku të dyja skuadrat u treguan të kujdesshme, Shqipëria nisi të fitojë terren. Në minutën e 16-të, Muçi krosoi drejt Seferit, por goditja me kokë e sulmuesit u ndal nga mbrojtja bjelloruse.

Momenti që ndryshoi ndeshjen erdhi në minutën e 32-të. Kontsevoi shkaktoi penallti pas ndërhyrjes ndaj Gjimshtit dhe pas konfirmimit nga VAR, Kristjan Asllani mori përsipër ekzekutimin. Mesfushori nuk gaboi dhe në minutën e 34-t shënoi për 1-0.

Kuqezinjtë vijuan të kërkonin golin e dytë dhe patën një tjetër mundësi të artë me Manajn në minutën e 38-të, por sulmuesi nuk arriti të dërgonte topin në rrjetë. Në anën tjetër, Barkoëski provoi me kokë, por Berisha kontrollloi pa vështirësi.

MOTI NE TIRANE

[Tirana, Albania](#)

POLITIKE

Tragjedia me 6 viktima në Athinë, reagon Ministria e Jashtme e Shqipërisë: Jemi thellësisht të pikëlluar

POLITIKE

Thirrja "urgjente"/ Rama mesazh shqiptareve nga Rinasia pas kthimit nga SHBA, zbardhen detajet

TRENDING

Destinacioni sekret: Wizz Air sjell në TIA 150 influencues dhe gazetarë për të zbuluar Shqipërinë

Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë

Në fundin e pjesës së parë, Shqipëria goditi sërish. Në shtesë një aksion i bukur u finalizua nga Ernest Muçi, i cili shfrytëzoi asistin spektakolar të Hysajt dhe dyfishoi avantazhin. 2-0 për Shqipërinë.

Pjesa e dytë nisi me ndryshime te Bjellorusia, ndërsa Shqipëria vazhdoi të ishte skuadra më kërkuese. Në minutën e 56-të, Seferi pati mundësinë për të shënuar edhe golin e tretë, por fali një rast të mirë.

Një minutë më vonë, Bjellorusia iu afrua golit me Pechenin, por tentativa e tij përfundoi jashtë. Shqipëria vazhdoi të krijonte raste, ndërsa në minutën e 64-t Asllani krosoi dhe Manaj goditi shtyllën, duke qenë shumë pranë golit të tretë.

Në minutat në vijim, trajneri kuqezi kreu zëvendësime, me Uzunin që hyri në vend të Seferit dhe më pas Dakun e Mehmetin që zëvendësuan Manajn dhe Muçin.

Shqipëria vijoi të kërkonte golin e tretë. Në minutën e 67-të, Muçi provoi brenda zonës, por topi përfundoi jashtë. Pak më vonë, Hoxha tentoi një supergol nga distanca, ndërsa edhe Pilo provoi nga larg, pa gjetur kuadratin.

Në minutën e 77-të ishte radha e Asllanit për të provuar nga distanca. Mesfushori që kishte hapur serinë e golave me penallti kërkoi një tjetër gol spektakolar, por goditja e tij preku rrjetën e jashtme.

Në fund, Shqipëria menaxhoi avantazhin dhe ruajti rezultatin 2-0, duke marrë një fitore të rëndësishme përballë Bjellorusisë.

Asllani nga pika e bardhë dhe Muçi me një finalizim të bukur vulosën suksesin kuqezi në "Air Albania", ndërsa Shqipëria tregoi efikasitet dhe kontroll në një sfidë ku pati mundësi për të shënuar edhe më shumë.

Kuqezinjtë marrin kryesimin e grupit së bashku me Finlandën, që shkatërroi San Marinon me shifrat 7-0.


LEXONI GJITHASHTU



Të flesh vonë mund të mos jetë zgjedhja më e mirë për zemrën



Tension në stadium, tifozët kuqezi me thirrje kundër qeverisë: Rama jepe dorëheqjen!



Dy yje, një histori e errët! Sydney Sweeney dhe Belmont Cameli bëhen bashkë për filmi e ri...

Rezultati live:

Shqipëri-Bjellorusi 2-0
Asllani 34', Muçi 45+1'

POLITIKË

"Paketa e Maleve është për pronarët"/ Kryeministri Rama nga Nju Jorku: Zvërneci sjell 4 miliardë euro, po studiojmë ndikimin në mjedis

POLITIKË

"Vezë, protestë dhe flamingo, u ndjeva si në Tiranë"/ Rama nga SHBA: Njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur

ME TE LEXUARAT



"Zbrazti karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...

[Lexo lajmin e plotë](#)



Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plotë](#)



Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plotë](#)



Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plotë](#)

Minutë pas minute:

90+3' Mbyllet ndeshja, Shqipëria merr fitoren e parë pas 5 ndeshjesh.

77' Dominim total i kuqezinjve, Muçi, Manaj dhe Hoxha i afrohen golit të tretë. Kërkohej goleadë.

64' Rey Manaj pranë golit të tretë, goditja e tij me kokë përplaslet në shtyllë.

56' Seferi shërbehet shumë mirë nga Asllani, por sulmuesi bën një gjuajtje shumë të dobët dhe humbet shans të madh.

55' Pasim nga e djathta në "zemër" të zonës sonë, bjellorusët humbin shans të madh përballë Berishës me një goditje që shkon mbi portë.

54' Detyra e vetme në këtë pjesë të dytë është menaxhimi dhe shfrytëzimi që mund të lënë bjellorusët mbrapa. Shqipëria vijon të jetë në sulm, por pa aventura.

46' Nis pjesa e dytë, kuqezinjtë kërkojnë të thellojnë shifrat dhe të vulosin 3 pikët.

45+3' Mbyllet pjesa e parë.

45+1' Gool Shqipëria 2-0! Ernest Muçi vjen edhe te kombëtarja dhe tregon klasin e tij me një gjuajtje të zgjuar. (Video)

36' Rey Manaj arrin të lirohet në një mundësi të artë, por nuk godet si duhet në momentin final.

34' Gool Shqipëria 1-0!! Manaj ia lë 11-metërshin Asllanit, që godet dhe tregohet i saktë për 1-0. (Video)

32' Gjimshiti arrin t'i marrë kohën kundërshtarit dhe fiton një penallti gjatë zhvillimeve të një goditjeje këndi.

31' Bjellorusët vënë në vështirësi skuadrën tonë me vrapimet e shumta dhe nuk e lejojnë të dalë rrjedhshëm në sulm. Ende nuk kemi bërë gjuajtje në kuadratin e bjellorusëve.

20' Ndeshja ul ritmin sa i përket rasteve, gabime, përplasje dhe faulle në mesfushë. Kombëtarja duket e paqartë në rrugën drejt portës kundërshtare.

7' Kuqezinjtë tregohen "të butë" në mbrojtje dhe lejojnë rivalët të rrezikojnë me një gjuajtje rreth 10 metra distancë. Fatmirësisht pret Berisha, i ndihmuar edhe nga gjuajtja e dobët e miqve.

5' Kuqezinjtë e nisin menjëherë me presing lart dhe tentojnë nga pozicione të ndryshme. Rasti më për tu shënuar: një goditje dënimi e ekzekutuar nga Manaj ngjitur me trekëndëshin e portës bjelloruse.

1' Nis ndeshja në "Air Albania".

Ndeshja e radhës për Shqipërinë është ajo ndaj San Marinos, e planifikuar të luhet pas 3 ditësh.

ME TE LEXUARAT

"Zbraz i karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dëfishtë" e Giovalin

NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

[Kliko për më shumë informacion](#)

Lazrit

[Lexo lajmin e plote](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plote](#)

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plote](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plote](#)

"Askush nuk është mbi ligjin"/ Rama shkarkon menjëherë Vlorë Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH

[Lexo lajmin e plote](#)

Sekuestrohet hoteli "Central Park Premium" në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket

[Lexo lajmin e plote](#)

"Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot"/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap

[Lexo lajmin e plote](#)

Lajmi Fundit



KUSH JEMI

KONTAKT REDAKSINË

TE DHENAT PERSONALE

COOKIES

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by **Mediadesk**

REGJISTROHU NË NEWSLETTER

OK

Ju do të merrni njoftime periodike me Lajmet e Fundit.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.